



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

i mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa i Komunës së Prishtinës, mbajtur më 27.2.2025.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina - kryesues i komitetit, Nora Kelmendi (VV), Mirsad Vitia (VV), Arbnora Berisha (VV), Gëzim Sveçla (VV), Jeta Rafuna (LDK), Milazim Vitija (LDK), Dhurata Jahaj - Retkoceri (LDK), Shegë Beqiri - Badivuku (PDK) dhe Leutrim Retkoceri (PDK).

Mungoi: Bahri Gashi (AAK).

Të pranishëm ishin edhe: Jehona Lushaku - nënkyetare dhe drejtore e Drejtorisë së Arsimit, Arbër Sadiki - drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, Sibel Halimi - drejtore e Drejtorisë së Kulturës, Valbona Makolli - drejtore e Drejtorisë së Financave, Kushtrim Mushica - drejtori i Drejtorisë së Sportit dhe Lulzim Fushtica - drejtor i Drejtorisë së Emergjencave.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Fehmi Kupina, kryesues i komitetit, me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin kushtuar artistit Faruk Begoli;
3. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin kushtuar dëshmorëve: Hyzri Talla, Afrim Malqi dhe Ilir Durmishi;
4. Propozim-vendimi për hartimin e Planit të hollësisht rregullues Çagllavicë;
5. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Shoqatën "Yjet që nuk vdesin";
6. Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor – 30 dhjetor 2024 (TM4);
7. Raport finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2024;
8. Propozim-vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2025-2026;
9. Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025;
10. Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike

- ✓ në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në kryeqytet, nr- 01-020/05-69249/23. dt. 3.4.2023;
- 11. Propozim-vendimi për përkrahje financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar;**
- 12. Propozim-vendimi për subvencionimin e transportit të nxënësve;**
- 13. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për artin dhe kulturën 2026-2031;**
- 14. Propozim-vendimi për miratimin e Rregullores për Subvencionet e Komunës së Prishtinës;**
- 15. Të ndryshme.**

Kryesuesi: - tha nëse keni ndonjë rekomandim për ndonjë pikë, para se të fillojmë me këtë rend të ditës.

Gëzim Sveçla: - tha se rekomandoj që pikën 11 dhe 12, t'i vendosim në fillim të rendit të ditës si pikë e 4 dhe 5, pasi janë pika që kanë qenë edhe në mbledhjet e kaluara dhe është bërë kohë e gjatë pa miratuar asnjë pikë.

Kryesuesi: - tha se rendi i ditës është bërë në koordinim me kryetarin, por nëse ju të gjithë pajtoheni, atëherë mund ta bëjë këtë ndryshim.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa

Me 9 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, kalon si pikë e rendit të ditës.

Pika e dytë - Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin kushtuar artistit Faruk Begolli.

Arbër Sadiki: - tha se kjo pikë ka ardh si kërkesë nga Fakulteti i Arteve dhe i artistëve. Ai tha se para disa muajve është aplikuar për caktimin e një lokacioni dhe pse ata vetë e kanë caktuar lokacionin e një memoriali dhe sot kemi vendosur që këtë ta sjellim si pikë të rendit të ditës. Sadiki tha se bëhet fjalë për parcelën 10297-0, Zona Kadastrale Prishtinë, parcela e ngjitur me sheshin “Nënë Tereza”, afér Ministrisë së Kulturës.

Nora Kelmendi:- tha se a jeni në bisedime pasi që parcela është bashkëpronësi e Kuvendit të Kosovës edhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, nuk është parcelë e Komunës së Prishtinës, duke pyetur se a mund të ndahet lokacioni.

Arbër Sadiki: - tha se i kemi shkruar Ministrisë së Kulturës, nuk na kanë kthyer përgjigje negative zyrtare, por na kanë thënë që janë disa drejtues që do të merren prapë me këtë dhe do të jemi në bashkëpunim me ta.

Pika e tretë

Propozim -vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin kushtuar dëshmorëve: Hivzi Talla, Afrim Maliqi dhe Ilir Durmishi.

Arbër Sadiki: - tha se këtë pikë e kemi diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar, mirëpo për shkak të mungesës të një kopjeje të planit, fletës poseduese origjinale, nuk kaloi dhe mendoj se nuk kishte

pyetje tjera për diskutim. Ai tha se po pajtohem që kur vendosim ndërtesë duhet me nda parcelën, por këtu bëhet fjalë për intervenime publike, të cilat janë të domosdoshme për t'i pasur.

Pika e katërt

Propozim-vendimi për përkrahje financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar.

Kryesuesi: - tha se këtë pikë mund ta kalojmë pasi që të njëjtën e kemi diskutuar në mbledhjen e kaluar.

Pika e pestë

Propozim-vendimi për subvencionimin e transportit të nxënësve.

Kryesuesi: - tha se edhe këtë pikë e kemi diskutuar në mbledhjen e kaluar.

Pika e gjashtë

Propozim-vendimi për hartimin e Planit të hollësishëm rregullues Çagllavicë.

Arbër Sadiki: - tha se bëhet fjalë për një iniciativë e hartimit të Planit të hollësishëm rregullues në Çagllavicë, e cila nuk është e vetmja zonë që nuk është e përfshirë në asnjë plan. Sadiki tha se këtë herë nuk e kemi përcjellur me link, për shkak të problemeve me we-transfer, por nëse keni ndonjë paqartësi jam i gatshëm për ta prezantuar edhe njëherë.

Gëzim Sveçla: - pyeti se me PZHK-në aktuale që ka skaduar, çfarë destinimi ka ajo pjesë dhe çfarë toke është.

Arbër Sadiki: - tha se një pjesë është që parashihet për zgjerim dhe një pjesë është e cila nuk është e përfshirë. Sadiki tha se është tokë bujqësore, mirëpo çdo plan që është hartuar deri sot për ata që i kanë përcjellë janë hartuar në toka bujqësore. Ai tha se pastaj në procedura ndërohet toka nga ajo bujqësore në atë ndërtimore dhe detyrimisht do të dërgohet në Ministrinë e Bujqësisë për miratim për shkak se nuk mund të vazhdohet me plan pa këtë aprovim.

Pika e shtatë

Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Shoqatën “Yjet që nuk vdesin”.

Gëzim Sveçla: - tha, pasi drejtoresha nuk gjendet këtu, ne kemi kanë shumë të qartë për pikat të cilat janë prezantuar, s'ka më nevojë për sqarime, por kjo është pikë e re.

Nora Kelmendi: - tha se duhet ta largojmë këtë pikë nga rendi i ditës dhe i tregoni se për këtë pikë duhet të aplikohet përmes subvencioneve dhe jo përmes subvencioneve të kryetarit.

Valbona Makolli: - tha se kam një sqarim të vogël para se ta largojmë nga rendi i ditës. Ajo tha se niveli qendror, domethënë qeveria ka formuar një grup punues ku përfshihen të gjitha komunat, dhe secilës ia ka dhënë detyrat e veta për festat 5, 6, 7, mars dhe tutje prill festat. Drejtoresha tha se Komuna e Prishtinës i di detyrat e veta dhe njëra prej tyre është prezantimi i një shfaqjeje, të cilën e ka përzgjedh kabinetin i kryetarit. Ajo tha se kjo shfaqje do të mbahet për ndër të 5, 6 dhe 7 Marsit në Prishtinë dhe do të participohet edhe nga komunat tjera.

Nora Kelmendi: - tha se duhet të aplikoni përmes subvencioneve nga Drejtoria e Kulturës, pasi kjo është e gjetur nga auditorët për disa vite. Nora tha se na duhet të largojmë këtë pikë nga rendi i ditës ashtu siç jemi dakorduar, pastaj në seancë të Kuvendit të njëjtën mund ta propozojnë.

Lulzim Fushtica: - tha se me vendim të Kryetarit jam caktuar si kryesues i këshillit organizativ për organizimin e festave, ditëve të shënuarA të kryeqytetit. Ai tha se jemi para Epopesë së UÇK-së 5, 6 dhe 7 Mars dhe kemi pranuar një kërkesë nga z. Prof. dr. Nysret Pllana për financimin e shfaqjes pas luftës “Kush jemi ne” që do të jetë pjesë e organizimit të kryeqytetit për shënimin e ditëve të lavdishme të Epopesë së UÇK-së. Fushtica tha se kanë kërkuar që kjo shfaqje të financohet dhe kryetari ka propozuar që të financohet kjo shfaqje me 20 mijë euro, kështu edhe kemi kërkuar që e njëjta të jetë si pikë e rendit të ditës për këtë seancë.

Gëzim Sveçla: - tha se propozimi është i jashtëligjshëm, kjo është OJQ dhe ka një Rregullore për financimin e organizatave joqeveritare që e parashek procedurën qysh duhet të financohen organizatat joqeveritare. Ai tha se kam informacione se kjo është e gjetur e përsëritur nga auditorët dhe për këto veprime që kanë ndodhur në Kuvend janë duke u zhvilluar edhe hetime.

Nora Kelmendi: - pyeti drejtoreshën se kur e keni afatin për me subvencionuar, në mënyrë që të bëhet shpalije publike.

Sibel Halimi: - tha se ne jemi duke bërë përgatitje të hënën, të martën dalin po në fakt kjo nuk përfshihet sepse është procedurë njëmuore, derisa të aplikohet dhe pastaj të shqyrtohet prej anëtarëve të komisionit.

Gëzim Sveçla: - tha se ata vetëm nëse aplikojnë dhe mjetet munden me i marrë pastaj retro, pasi problemi është me procedurat.

Sibel Halimi: - tha se nuk janë duke u shqyrtuar saktësisht, sepse komisioni e tejkalon vlerën 2 % dhe komisioni vendos për subvencionet, jo Drejtoria e Kulturës, kështu që nëse ne vendosim tash, atëherë bëjmë prapë shkelje ligjore. Ajo tha se nuk jemi këtu për të bërë ndonjë shkelje, por ideja për shfaqjen ishte thjeshtë fantastike, e cila ka të bëjë me mënyrën se si shoqëria jonë ka kaluar nëpër luftë dhe është në harmoni me vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Gëzim Sveçla: - tha se asnjë problem se kemi me shfaqjen apo me konceptin e saj, kjo është shumë e mirëpritur, problemin e kemi me procedurat sepse për të njëjtat raste si për shembull ndarja e subvencioneve në sport që janë miratuar në Kuvend, sot janë duke u zhvilluar hetime nga krimet ekonomike.

Pika e tetë

Raport finanziar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor – 30 dhjetor 2024 TM4, dhe

Pika e nëntë

Raport finanziar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar- 31 dhjetor 2024

Valbona Makolli: - tha se për tremujorin e fundit të vitit 2024, janë shpenzuar 57 milionë e 832,858.06 cent, të ndara në 5 kategori ekonomike: paga dhe mëditje 23.53%, mallra dhe shërbime 31.93%, komunalitë 57.91% dhe shpenzimet e investimeve kapitale 38.54%. Ajo tha se krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023 dhe 2024, shpenzimet në total kanë një rritje prej 24%.

Drejtoresha tha se në këtë raport janë paraqitur shpenzimet e investimeve kapitale për të gjitha drejtoritë dhe po ashtu llogaritë e arkëtueshme dhe pasuritë jokapitale të cilat janë të përsëritshme, përvèç raportit vjetor i cili nxitet edhe prej pasqyrave financiare që i bart secila prej kompanive. Ajo shtoi se nga vendimet gjyqësore për periudhën tector-dhjetor 2024 nga thesari janë ekzekutuar 3 milionë e 871 mijë e 994.78 euro, diku 95% përfshijnë kontratat kolektive të arsimit dhe shëndetësisë.

Gëzim Sveçla: - tha se lidhur me këtë raport kemi shumë pyetje për drejtorë, në lidhje me disa pagesa të projekteve. Ai tha për shembull rruga "Antigona Fazliu" janë ndarë 203 mijë euro, ndërsa unë banoj pikërisht aty, nuk është punuar asgjë dhe nuk e di se ku kanë shkuar ato para. Sveçla tha se janë diku rrëth 5 milionë, vetëm në projekte të mëdha që janë marr, a mundemi me i shiku se cilat janë ato projekte.

Valbona Makolli: - tha se ato mjete ka mundësi të janë përbartimore, për shkak se këtë vit 10.5 milionë na i kanë marrë vetëm përbartuesit. Ajo tha se në reportin vjetor janë të paraqitura të gjitha se në cilat projekte janë marr, ndërsa materialin ndaras veç e veç për të gjitha projektet e kemi kërkesë nga auditorët, jemi duke e punuar dhe posa ta kemi të gatshëm do ta përcjellim edhe te ju.

Gëzim Sveçla: - tha se janë vetëm disa projekte të cilat e kalojnë shumën prej 5 milionë, si p.sh., nënkalimi "Agim Ramadani" janë marrë 9,700,000 (nëntë milionë e shtatëqind mijë) euro, rregullimi i sheshit "Xhorxh Bush" 1,700,000 (një milion e shtatëqind mijë) euro, spitali i Prishtinës 1,500,000 (një milion e gjysmë) euro, salla multifunksionale e koncertit 2,800,000 (dy milion e tetëqind mijë euro) euro, pastaj ishulli në lagjen Arbëria dhe shumë të tjera të cilat do të ishte mirë të sqarohen në seancë.

Leutrim Retkoceri: - tha se nuk është në pyetje veç rapporti finanziar për periudhën tector-dhjetor TM4, por shumë më i rëndësishëm është arsyetimi i rapporti finanziar për vitin 2024 dhe raportimi të bëhet nga drejtorët e drejtoreve përkatëse.

Pika e dhjetë

Propozim-vendimi lidhur me Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2025 – 2026, është diskutuar në mbledhjet e kaluara.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit për vitin 2025, do të diskutohet në seancë të Kuvendit.

Pika e dy mbëdhjetë

Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkësave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në kryeqytet, nr 01-020/05-69249/23/ dt. 03.04.2023, e diskutuar në mbledhjen e kaluar.

Pika e trembëdhjetë

Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për artin dhe kulturën 2026-2031, e diskutuar në mbledhjen e kaluar.

Pika e katërmëdhjetë

Propozim-vendimi për miratimin e Rregullores për subvencionet e Komunës së Prishtinës.

Jehona Lushaku-Sadriu: - tha se ka qenë pjesë e komisionit që kanë punuar në këtë rregullore dhe qëllimi i hartimit të kësaj rregullore është parandalimi. Sqarimi i shumë problemeve dhe kërkesave të palëve në lidhje me ndarjen e subvacioneve në fusha të ndryshme. Ajo tha se të njëjtën projekt-rregullore e kemi pasur edhe në diskutim publik dhe i kemi pranuar të gjitha rekomandimet dhe kërkesat që na janë adresuar.

Nora Kelmendi: - tha se në mbledhjen e kaluar të KPF-së, ne i kemi pasur disa sugjerime të cilat nuk janë marrë parasysh, nëse ka mundësi që gjatë seancës të na jepet një përgjigje rreth tyre.

Gëzim Sveçla:- pyeti se cilat janë ndryshimet që kanë ndodh në këtë rregullore nga ajo e kaluara.

Jehona Lushaku-Sadriu: - tha se janë disa detaje si shembull në Drejtorinë e Arsimit, subvencionimi i nxënësve më të dalluar të shkollave të mesme dhe disa sugjerime të tjera që kanë të bëjnë me këtë drejtori. Ajo tha se për sqarimet në lidhje me drejtoritë e tjera besoj se ato do t'i merrni gjatë seancës në Kuvend.

Leutrim Retkoceri: - tha nëse mundeni nesër me na bashkëngjitë listën e komenteve, cilat janë pranuar dhe cilat janë refuzuar edhe arsyen pse janë refuzuar para votimit të rregullores. Ai tha është mirë që ne si Kuvend me i pas komentet nga dëgjimi publik edhe komentet që i kanë jep grupet e interesit për rregulloren.

Mbledhja mbaroi në orën 11: 00.

Procesmbajtësi
Arton Brahimi

Kryesues i Komitetit
Fehmi Kapina

